# FLETORJA ZYRTARE

## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2020 – Numri: 81

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E mërkurë, 6 maj 2020**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr.358, datë 4.5.2020 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i objekteve "Rikonstruksioni i shkollës "Thanas Bozo", ndërtimi i palestrës dhe terrenet sportive Kolonjë", Bashkia Lushnjë........................................... | 4561 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr.359, datë 4.5.2020 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private,dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, për shpalljen e zonës së re për zhvillim, në njësinë administrative Laç, Bashkia Kurbin.............................................. | 4562 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr.360, datë 4.5.2020 | Për një shtesë në vendimin nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19"........................................................................................ | 4568 |
| Vendim i Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile nr.17, datë 28.4.2020 | Për një ndryshim në urdhrin nr.193, datë 20.3.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "Për detajimin e aktiviteteve sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike"................................................ | 4568 |
| Vendim i Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile nr.18, datë 29.4.2020 | Për miratimin e listës me strukturat e reja akomoduese për akomodimin e përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19......................................................... | 4569 |

**VENDIM**
**Nr. 358, datë 4.5.2020**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I OBJEKTEVE "RIKOSTRUKSIONI I SHKOLLËS "THANAS BOZO", NDËRTIMI I PALESTRËS DHE TERRENET SPORTIVE KOLONJË", BASHKIA LUSHNJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i objektit "Rikostruksioni i shkollës "Thanas Bozo", ndërtimi i palestrës dhe terrenet sportive Kolonjë", Bashkia Lushnjë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", me vlerë të përgjithshme prej 1 930 435 (një milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 930 435 (një milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e pesë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë, për vitin 2020.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare" dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurive të paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Lushnjë.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë, në favor të Bashkisë Lushnjë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**Lista e pronarëve të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i objektit :**
**"Rikostruksioni i shkollës 'Thanas Bozo', ndërtimi i palestrës dhe terrenet sportive Kolonjë"**

| Nr | ZK | Nr. i Pasurisë | Adresa | Pronari | Sipërfaqja truallit (m²) | Cmimi i truallit (lekë/m²) | Vlera truallit (lekë) | Sip. Ndërtesës (m²) | Cmimi i ndërtesës (lekë/m²) | Vlera ndërtese (lekë) | Vlera totale truall dhe ndërtesë (lekë) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2207 | 3//36 | Kolonjë Lushnje | Asqeri Çela | 100 | 451 | 45,100 | 74 | Me situacion | 1,885,335.0 | 1,930,435.0 | Shkresa nr. 7272/1 prot. dt. 11/09/2019; Vërtetim Hipotekor dt. 07/08/2019 |
| **Total** | | | | | | | | | | | **1,930,435** | |

Shënime:
1.Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM nr. 89, dt.03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".
2.Për ndërtesën, vlera është llogaritur sipas përcaktimeve të VKM nr. 138 dt. 23.03.2000 "Për Kriteret Teknike të Vlerësimit dhe të Përllogaritjes së Masës së Shpërblimit të Pasurive
Pronë Private që Shpronësohen, të Pasurive që Zhvlerësohen dhe të të Drejtave të Personave të Tretë, për Interes Publik", i ndryshuar, ku çmimet janë marrë nga Enti Kombëtar i Banesave.

## VENDIM
## Nr. 359, datë 4.5.2020

## PËRSHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,DHE SHKËMBIMIN E PRONËS, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE LAÇ, BASHKIA KURBIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, teäktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë nayrore", të vendimit nr.7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës për interes publik në funksion të procesit të rindërtimit", të vendimitnr.8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Përcaktimin e kushteve dhe të kritereve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje", si dhe të vendimit nr.46, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë administrative Laç, Bashkia Kurbin, dhe caktimin e Entit Kombëtar të Banesave si njësi zbatuese", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, që do të realizohet në zonën 1/1, njësia administrative Laç, Bashkia Kurbin, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2.Shpronësimi dhe shkëmbimi i pronës të bëhen në favor të Entit Kombëtar të Banesave, si njësi zbatuese.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë "arë", "kultura bujqësore", si dhe për pasuritë e llojit tokë "truall", referuar shënimit në tabelë, me vlerë 43 009 339 (dyzet e tre milionë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e nëntë) lekë.

4.Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 43 009 339 (dyzet e tre milionë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e nëntë) lekësh, do të përballohet nga zëri "Fondi për rindëritimin", i miratuar për vitin 2020.

5.Shkëmbimi i pasurive private të llojit "ndërtesë" dhe tokë "truall", me një pasuri tjetër të paluajtshme në pronësi të shtetit, aktuale ose të ardhshme, do të bëhet referuar legjislacionit në fuqi, cilësimeve në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi si dhe marrëveshjeve/kontratave që janë lidhur dhe do të lidhen, ndërmjet Entit Kombëtar të Banesave dhe qytetarëve që shprehin dakordësinë.

6.Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi dhe shkëmbimi të pronës, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë origjinale ose duplikat, kartelën e pasurisë të rifreskuar si dhe

hartën treguese të regjistrimit, pranë Entit Kombëtar të Banesave.

7.Për pasuritë që kanë rezultuar në proces legalizimi në momentin e shpronësimit, pronarët, të kompensohen, për efekt shpronësimi dhe shkëmbimi të pronës, pasi të kenë paraqitur vërtetimin e statusit që konfirmon se pasuria ka qenë në proces legalizimi, të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

8. Enti Kombëtar i Banesave të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të shpronësuar, dhe të bëjë shkëmbimin e pronës, referuar përcaktimeve në këtë vendim.

9.Afati i kryerjes së shpronësimit në vlerë monetare do të jetë momenti i fillimit të realizimit të projektit. Afati i kryerjes së shkëmbimit të pronës private me një pronë shtetërore të ardhshme do të jetë në përfundim të realizimit të projektit për zhvillimin e zonës 1/1, njësia administrative Laç, Bashkia Kurbin.

10. Enti Kombëtar i Banesave i kërkon Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit të shpronësimit dhe të shkëmbimit ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës, në rast se kompensimi kryhet nëpërmjet shkëmbimit të pronës private me një pasuri shtetërore të ardhshme, në kartelën e pasurisë për pronën truall, ku do të krijohet pasuria e ardhshme, regjistruar në AgjencinëShtetërore të Kadastrës, bëhet regjistrimi i barrës ligjore sipas legjislacionit në fuqi, në favor të pronarit privat, për përfitimin në të ardhmen të pasurisë shtetërore, kur kjo e fundit të regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Kur pronari/pronarët privat/ë ka/në pranuar kushtet e shkëmbimit, pjesë të kërkesës për regjistrim janë dhe marrëveshjet përkatëse. Me regjistrimin e pasurisë së ardhshme në regjistrin përkatës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me kërkesë të njësisë zbatuese dhe të përfaqësuesit të pronarit shtet bëhet regjistrimi i kalimit të të drejtave të pronësisë për pronën shtet, në favor të pronarit privat.

11. Enti Kombëtar i Banesave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin, t'i kërkojë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që të kryejë regjistrimin e pasurive, pronë private, të shpronësuara dhe të shkëmbyera, sipas legjislacionit në fuqi.

12.Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë këshillit të Qarkut Lezhë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, të pasqyrojë në regjistrat kadastralë ndryshimin e kategorisë së resursit të pasurive të paluajtshme, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në kategorinë "tokë urbane" "truall".

13. Gjatë periudhës së zbatimit të projektit (përfundimin e punimeve) qytetarët, nëse nuk kanë në pronësi ose në posedim objekte të tjera banimi, do të strehohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet programeve të rindërtimit, të parashikuara në aktin normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", ose në legjislacionin në fuqi për strehimin social.

14. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

15. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Entit Kombëtar të Banesave, për pasuritë e shpronësuara.

16. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Enti Kombëtar i Banesave dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**ENTI KOMBËTAR I BANESAVE**

## PËR ZHVILLIMIN E DETYRUAR "ZONË TË RE PËR ZHVILLIM" NË ZONËN 1/1, NJËSIA ADMINISTRATIVE LAÇ, BASHKIA KURBIN.

| Nr. | PRONARI | | | TË DHËNAT(mbi pasurinë sipas ASHK) | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË | | | | | | | | | | | | VLERA TOTALE (lekë) | Konpensim/ Shkëmbim | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Sip. | Shpronësim tokë "arë" | | | Shpronësim tokë "truall" | | | Ndërtesë banimi (shtëpi) | | | Ndërtesë jo banimi | | Vlera e Kulturës bujqësore dhe Drufrutorë | | | |
| | Emri | Atësia | Mbiemri | ZK | Nr.Pas | Lloji | Totale (m2) | Sip. (m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera (lekë) | Sip. (m2) | Çmimi (lekë/m2) | Vlera (lekë) | Sip.Ndërt. konf. ASHK (m2) | Çmimi mes. sh/blerjeve sipas zvrpp (l/m2) | Vlera (lekë) | Sip.Nd. konf.nga ASHK (m2) | Vlera sipas Preventivit (lekë) | Vlera (lekë) per shperblim | | | |
| PRONE PRIVAT | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Ndue | Pashk | Suti | 2364 | 3/714/ND | Ndertese | 325.28 | | | | | | | 325.28 | 27,863 | **9,063,276.64** | | | | **9,063,276.64** | Shkembim | Konfirmuar ASHK, 6.02.2020 |
| 2 | Agostin | Preng | Bardhi | 2364 | 4/801 | Truall | 5,808 | | | | 618 | 1,620 | **1,001,160** | | | - | | | | **1,001,160** | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 6.02.2020 |
| 3 | Vlash | Nikoll | Suti | 2364 | 3/720/2 | Are | 600 | 600 | 321 | **192,600** | | | - | | | - | | | **167,326** | **359,926** | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 |
| 4 | Emiljan GentiAnila Frange | Lek Lek Lek Kol | SutiSuti VelaSuti | 2364 | 3/714/1 | Are | 2,100 | 2,100 | 321 | **674,100** | | | - | | | - | | | **105,100** | **779,200** | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 |
| 5 | Ndue | Pashk | Suti | 2364 | 3/720/6 | Are | 1,809 | 1,809 | 321 | **580,689** | | | - | | | - | | | **57,014** | **637,703** | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 |
| 6 | Vlash | Nikoll | Suti | 2364 | 3/716/1 | Are | 1,550 | 1,550 | 321 | **497,550** | | | - | | | - | | | | **497,550** | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 5.02.2020 |
| 7 | Ndue | Pashk | Suti | 2364 | 3/713/2 | Are | 942 | 942 | 321 | **302,382** | | | - | | | - | | | | **302,382** | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 3.02.2020 |
| 8 | Zef | Pal | Suti | 2364 | 3/827-ND | Ndertese | 104.43 | | | - | | | - | 104.43 | 27,863 | **2,909,733.09** | | | | **2,909,733.09** | Shkembim | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 |
| 9 | DhimiterMarte | NdokZef | TrokthiTrokthi | 2364 | 4/1578/ND | Ndertese | 270.26 | | | - | | | - | 270.26 | 27,863 | **7,530,254.38** | | | | **7,530,254.38** | Shkembim | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 |
| 10 | Mark | Gjin | Zymaj | 2364 | 4/634/1 | Truall | 3,375 | | | - | 3,375 | 1,620 | **5,467,500** | | | - | | | | **5,467,500** | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 5.02.2020 |
| 11 | Mhill | Gjok | Gjinaj | 2364 | 4/802 | Truall | 750 | | | - | 750 | 1,620 | **1,215,000** | | | - | | | | **1,215,000** | Kompesim ne vlere | **Ne proces gjyqesor. Ne seksionin E ka shenimin: "Mbi kete truall ka nje ndertim te pa ligjshem" / eshte pronar me vertetim hipotekor** |
| 12 | Llesh Preng | PjeterNdue | Zima Zymaj | 2364 | 3/397 | Truall | 1,228.50 | | | - | 1,228.5 | 1,620 | **1,990,170** | | | - | | | | **1,990,170** | Kompesim ne vlere | **Konfirmuar ASHK, 5.02.2020 Urdher per venin e sekuestros konservative date 04.02.2014, Z. Perbarimore Kurbin / eshte pronar** |
| 13 | Llesh Preng | PjeterNdue | Zima Zymaj | 2364 | 4/634/2 | Truall | 265 | | | - | 265 | 1,620 | **429,300** | | | - | | | | **429,300** | Kompesim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 |
| 14 | Fran | Ndrek | Suti | 2364 | 3/435 | Are+Truall | 348 | 248 | 321 | **79,608** | 100 | 1,620 | **162,000** | 60 | 27,863 | **1,671,780.00** | | | **93,590** | **2,006,978** | Shkembim per ndertesen/ dhe kompesim ne vlere per truallin, token "are" dhe kulturat bujqesore | **"Kufizohen veprime mbi pasurinë për shkak të mungesës së dokumentacionit tekniko-ligjor"** |
| 15 | Pal | Ndrek | Suti | 2364 | 3/386 | Truall | 200 | | | | 200 | 1,620 | **324,000** | 82 | 27,863 | **2,284,766.00** | | | **66,720** | **2,675,486** | Shkembim per ndertesen/ dhe | Konfirmuar ASHK, 5.02.2020 Shenime ne |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | kompesim ne vlere per truallin dhe kulturat bujqesore | seksionin E :' Mbi kete truall ka 2 ndertimi te paligjshme dhe Urdher sekuestro Nr.793 dhe Nr. 349, data 15.07.2019, Permbarues A.M.A. |
| 16 | Dod Zef | VlashVlash | Zymaj Zymaj | 2364 | 3/396 | Truall | 520 | | | | 520 | 1,620 | **842,400** | | | | 800 | **23,927,766** | | **24,770,166** | Kompesim ne vlere | Mbi kete truall rezulton objekt me Leje Ndertimi Nr. 4, date 07.05.2010 me afat kohor deri me date 20.05.2011. Plotesim dokumentacioni. |
| 17 | Fran GjokGjonLles hMarkNdoc Nikoll Preng | Ndue NdueVlashPjete rGjinVlashPjeter Ndue | Zymaj Zymaj | 2364 | 3/398 | Truall | 412.50 | | | | 412.50 | 1,620 | **668,250** | | | | | | | **668,250** | Kompensim ne vlere | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020 Ne seksionin e ka shenimin; "Urdher per venien e Sekuestros konservative date 04.02.2014, Zyra Permbarimore Kurbin" |
| 18 | Vid | Ndoc | Prenga | 2364 | 3/232 | Truall | 113 | | | | 113 | 1,620 | **183,060** | | | | 74 | 2,678,012 | | **2,861,072** | Shkembim per ndertesen dhetruallin | Konfirmuar ASHK, 4.02.2020. Po pergatiten procedurat e mosperfshirjes ne procesin e legalizimeve per katin 1+1 |
| 19 | Tonin | Gjon | Lala | 2364 | 4/1206-nd | Njesi | 100.90 | | | | | | | | | | 100.9 | **3,308,759** | | **3,308,759** | Shkembim | Konfirmuar ASHK, 13.02.2020 |
| 20 | Pal Trokthi Gjergj NokajDeo Pjeter Vathi Nikoll BardhiDeo Prodani Vlash Nokaj | | | 2364 | 4/1222/5 | Truall | **845.00** | | | | 845 | 1,620 | **1,368,900** | | | | | | | **1,368,900** | Kompensim ne vlere | Konfirmuar nga ASHK, 11.03.2020 |
| 21 | Pal Trokthi Gjergj Nokaj Deo Pjeter Vathi Nikoll BardhiDeo Prodani Vlash Nokaj | | | 2364 | 4/1222/4 | Truall | **400.00** | | | | 400 | 1,620 | **648,000** | | | | | | | **648,000** | Kompensim ne vlere | Konfirmuar nga ASHK, 11.03.2020 |
| 22 | Pal Trokthi Gjergj Nokaj Ded Pjeter Vathi Nikoll BardhiDed Prodani Vlash Nokaj | | | 2364 | 4/1222/3 | Truall | **930.00** | | | | 930 | 1,620 | **1,506,600** | | | | | | | **1,506,600** | Kompensim ne vlere | Konfirmuar nga ASHK, 11.03.2020 |
| 23 | Kol Liksani Gjin TrokthiMark Bardhi | | | 2364 | 4/1218-nd | Ndertese | **240.00** | | | | | | **-** | | | | 240 | **834,732** | | **834,732** | Shkembim | Konfirmuar nga ASHK, 11.03.2020 |
| 24 | Zef | Pal | Suti | 2364 | 3/827 | Are | **1,600.00** | 1,600.00 | 321.00 | **513,600.00** | | | **-** | | | | | | **128,014** | **641,614** | Kompensim ne vlere | Konfirmuar nga ASHK, 11.03.2020 |
| 25 | Andon | Mark | Pula | 2364 | 3/722 | Truall | **300.00** | | | | 300.00 | 1,620 | **486,000** | 112.2 | 27,863.00 | **3,126,228.60** | | | | **3,612,229** | Shkembim | Sipas VKM nr. 442 dt. 18.07.2018 dhe vendimit nr. 41 dt. 08.02.2020 te DVASHK Lezhe |
| 26 | Frange<br>Gent | Kol<br>Lek | Suti<br>Suti | 2364 | 3/714-ND | Ndertese | **159.90** | | | | | | | 159.9 | 27,863.00 | **4,455,293.70** | | | | **4,455,294** | Shkembim | Drejtoria Vendore e ASHK Lezhe, Urdher nr. 39 dt. 08.04.2020 Per kalim pronesie te objektit. |
| 27 | KostandinMartin | VlashNikoll | Suti | 2364 | 3/720-ND1 | Ndertese | **183.67** | | | | | | | 113.23 | 27,863.00 | **3,154,927.49** | | | | **5,117,597.21** | Shkembim | Vendim nr.42 dt. 09.04.2020 i vendimit 442 dt. 18.07.2018 |
| | Davide Morena | MarkAbdyl | | | | | | | | | | | | 70.44 | 27,863.00 | **1,962,669.72** | | | | | Shkembim | |
| 28 | Ndue Angjelina | PashkMhill | Suti | 2364 | 3/720-ND | Ndertese | **124.43** | | | | | | | 76.22 | 27,863.00 | **2,123,717.86** | 48.21 | **411,394** | | **2,535,111.86** | Shkembim | Vendim nr. 40 dt. 08.04.2020 i vendimit 442 dt. 18.07.2018 |
| **Shuma paraprake per pasurite private** | | | | | | | | | | **2,840,529** | | | **16,292,340** | | | **38,282,647.48** | | **31,160,663** | **617,764** | **89,193,943.48** | | |
| **NE PROCES LEGALIZIMI NE ASHK** | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1 | Kostandin | Vlash | Suti | 2364 | 3/1252 | Njesi | **37.38** | | | | | | | | | | 37.38 | **322,043** | | **322,043.00** | Shkembim | Po pergatiten procedurat e mosperfshirjes ne procesin e legalizimeve sipas Vendimit te Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 6.1.2020. |
| 2 | Leonard | Lek | Trokthi | 2364 | 4/1252 | Njesi | **123.00** | | | | | | | | | | 123 | **3,433,741** | | **3,433,741.00** | Shkembim | Eshte perfunduar procedura ligjore per |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | perjashtimin nga procesi i legalizimit sipas Vendimit te Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 6.1.2020 |
| 3 | Zef | Pal | Suti | 2364 | 3/826 | Njesi | **21.71** | | | | | | | | | | 21.71 | **137,097** | | **137,097.00** | Shkembim | Po pergatiten procedurat e mosperfshirjes ne procesin e legalizimeve sipas Vendimit te Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 6.1.2020. |
| 4 | Zef | Pal | Suti | 2364 | 3/631 | Ndertese | **41.59** | | | | | | | 41.59 | 27,863.00 | **1,158,822.17** | | | | **1,158,822.17** | Shkembim | Po pergatiten procedurat e mosperfshirjes ne procesin e legalizimeve sipas Vendimit te Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 6.1.2020 |
| 5 | Anila | Tahir | Suti | 2364 | 3/1254 | Ndertese | **325.88** | | | | | | | 325.88 | 27,863 | **9,079,994.44** | | | | **9,079,994.44** | Shkembim | Po pergatiten procedurat e mosperfshirjes ne procesin e legalizimeve sipas Vendimit te Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 6.1.2020 |
| 6 | Leonard | Llesh | Trokthi | 2364 | 4/1217 | Ndertese | **165.87** | | | | | | | 165 | 27,863 | **4,597,395** | | | | **4,597,395.00** | Shkembim | Me shkresen e ASHK, DV Lezhe, nr. 1341/1, date13.02.2020 ka shenimin:Objekt shteteror i privatizuar. |
| 7 | Leonard | Lek | Trokthi | 2364 | 4/1253 | Njesi | **253.15** | | | | | | | | | | 253.15 | **834,732** | | **834,732.00** | Shkembim | Me shkresen e ASHK, DV Lezhe, nr. 1341/1, date13.02.2020 ka shenimin:Objekt shteteror i privatizuar. |
| 8 | Mikel | Ndok | Trokthi | 2364 | 4/1578 | Njesi | **274.00** | | | | | | | | | | 274 | **1,288,816** | | **1,288,816.00** | Shkembim | Me shkresen e ASHK, DV Lezhe, nr. 1341/1, date13.02.2020 ka shenimin:Objekt shteteror i privatizuar. |
| | | | | | | | | | | | | | | | | **14,836,211.61** | | **6,016,429** | | **20,852,640.61** | | |
| **PRONE SHTET** | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| **1** | Shtet | | | 2364 | 3/722/1 | Truall | **261.00** | | | | | | | | | | | | | | | |
| **2** | Shtet | | | 2364 | 4/1222/2 | Truall | **6,899.00** | | | | | | | | | | | | | | | |
| **3** | Bashkia Kurbin | | | 2364 | 3//1 | Ndertese | **4,585.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **4** | Republika e Shqiperise | | | 2364 | 3/394 | Truall + Ndertese | **2,981.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **5** | Shtet | | | 2364 | 4/1207 | Truall | **1,722.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **6** | Shtet | | | 2364 | 4/1226 | Trotuare | **75.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **7** | Shtet | | | 2364 | 3/822 | Trotuare | **68.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **8** | Shtet | | | 2364 | 3/824 | Trotuare | **25.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **9** | Shtet | | | 2364 | 3/713/3 | Are | **1,230.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **10** | Shtet | | | 2364 | 4/1155 | Truall | **396.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **11** | Shtet | | | 2364 | 3/732 | Trotuare | **241.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **12** | Shtet | | | 2364 | 3/733 | Trotuare | **155.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **13** | Shtet | | | 2364 | 4/1221 | Trotuare | **432.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **14** | Shtet | | | 2364 | 3/735 | Trotuare | **410.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **15** | Shtet | | | 2364 | 3/826 | Truall | **25.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **16** | Shtet | | | 2364 | 3/825 | Shesh | **574.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **17** | Shtet | | | 2364 | 3/717 | Kanal | **1,547.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **18** | Shtet | | | 2364 | 3/720/7 | Truall | **30.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **19** | Shtet | | | 2364 | 3/720/5 | Are | **1,147.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **20** | Shtet | | | 2364 | 4/107 | Rruge | **135.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **21** | Shtet | | | 2364 | 3/823 | Truall | **59.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **22** | Shtet | | | 2364 | 4/1210 | Truall | **65.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **23** | Shtet | 2364 | 3/710 | Truall | **236.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **24** | Shtet | 2364 | 3/714/2 | Are | **561.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **25** | Shtet | 2364 | 4/1213 | Truall | **854.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **26** | Shtet | 2364 | 4/1215 | Truall | **364.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **27** | Shtet | 2364 | 4/1218 | Truall | **1,951.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **28** | Shtet | 2364 | 4/1217 | Truall | **443.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **29** | Shtet | 2364 | 4/1216 | Truall | **398.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **30** | Shtet | 2364 | 4/1225 | Shesh | **233.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **31** | Shtet | 2364 | 4/109 | Rruge | **148.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **32** | Shtet | 2364 | 3/715 | Truall | **1,449.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **33** | Shtet | 2364 | 3/730 | Truall | **582.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **34** | Shtet | 2364 | 3/721 | Truall | **218.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **35** | Shtet | 2364 | 3/828 | Are | **375.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **36** | Shtet | 2364 | 3/711 | Truall | **463.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **37** | Shtet | 2364 | 3/728 | Truall | **657.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **38** | Shtet | 2364 | 3/729 | Truall | **626.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **39** | Shtet | 2364 | 4/1208 | Shesh | **1,265.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **40** | Shtet | 2364 | 3/718 | Rruge | **2,647.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **41** | Shtet | 2364 | 4/1206 | Truall | **335.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **42** | Shtet | 2364 | 4/1211 | Truall | **33.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **43** | Shtet | 2364 | 4/097 | Truall | **68.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |
| **44** | Shtet | 2364 | 4/1212 | Shesh | **169.00** | | | | | | | | | | | | | **0** | | |

Çmimet për shpronësim tokë "arë" është llogaritur sipas shkresësme nr.2135/1 prot datë 20.02.2020 ardhur nga Agjencia e Trajtimit të Pronave dhe çmimi tokë "truall" janë llogaritur sipas Vendimit nr. 89, datë 3.2.2016 "*Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë*", çmimet për ndërtesa banimi janë llogaritur sipas çmimit mesatar të shit/blerjeve sipas ZVRPP-sëreferuar shkresës me Nr. Prot 674/1 datë 06.02.2020 (ASHK Kurbin), ndërsa vlera e "*kulturë bujqësore dhe drufrutorë*" u llogarit në bazë të Udhëzimit Nr.1, datë 05.10.2000 "*Për kriteret teknike të përllogaritjes së vlerës së bimëve drufrutorë që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklarurar të shitblerjes*", çmimet për "njësi" janë llogaritur me situacion nga Komisioni i ngritur nga Njësia Zbatuese EKB.

**VENDIM**
**Nr. 360, datë 4.5.2020**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.311, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË AKOMODIMIT TË PËRKOHSHËM TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN SI REZULTAT I GJENDJES SË SHKAKTUAR NGA COVID-19"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1, të vendimit nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Përjashtimisht nga sa parashikohet në këtë vendim, akomodimi dhe/ose vetëkarantinimi i personave që riatdhesohen mund të bëhet edhe në banesat e tyre. Rregullat më të hollësishme mbi rastet përjashtimore të akomodimit / vetë-karantinimit përcaktohen me urdhër të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 17, datë 28.4.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.193, DATË 20.3.2020, TË MINISTRIT TË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, "PËR DETAJIMIN E AKTIVITETEVE SIPAS NOMENKLATURËS SË AKTIVITETEVE EKONOMIKE"**

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", të ndryshuar, Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore, i mbledhur sot më 28.4.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së aktiviteteve të lejuara, sipas urdhrit nr.193, datë 20.3.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "Për detajimin e aktiviteteve sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike", të ndryshuar, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINISTROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**Lista e aktiviteteve të lejuara:**

| | | |
|---|---|---|
| Lejohen | 4719 | Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara |
| Lejohen | 4771 | Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara |
| Lejohen | 4778 | Shitje me pakicë të mallrave të tjera të reja në dyqane të specializuara (Përfshirë dhe Tregtia me pakicë e Armëve dhe Municioneve, Artikujve Ushtarakë). |
| Lejohen | 4932 | Aktiviteti i taksive |
| Lejohen | 4751 | Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara |
| Lejohen | 4772 | Tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure në dyqane të specializuara |
| Lejohen | 9609 | Aktivitete te tjera p.k.t |
| Lejohen | 4759 | Tregtia me pakicë e mobiljeve, pajisjeve të ndriçimit dhe artikujve shtëpiakë në |

| | | |
|---|---|---|
| | | dyqane të special izuara p.k.t |
| Lejohen | 4776 | Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farave, plehëruesve, kafshëve të shtëpisë dhe ushqimit të tyre në dyqane të specializuara |
| Lejohen | 4777 | Tregtia me pakicë e orëve dhe bizhuterive në dyqane të specializuara |
| Lejohen | 4743 | Tregtia me pakicë e pajisjeve audio dhe video në dyqane të specializuar |
| Lejohen | 5920 | Regjistrimi i zërit dhe aktivitete të publikimit të muzikës |
| Lejohen | 4753 | Tregtia me pakicë e qylymave, sixhadeve, veshjeve të mureve dhe dyshemeve në dyqane të specializuara |
| Lejohen | 4765 | Tregtia me pakicë e lojrave dhe lodrave në dyqane të specializuara |
| Lejohen | 4763 | Tregtia me pakicë e regjistruesve muzikorë dhe video në dyqane të specializuara |
| Lejohen | 4764 | Tregtia me pakicë e pajisjeve sportive në dyqane të specializuara |
| Lejohen | 4742 | Tregtia me pakicë e pajisjeve të telekomunikacionit në dyqane të specializuar. |

**VENDIM**
**Nr. 18, datë 29.4.2020**

## PËR MIRATIMIN E LISTËS ME STRUKTURAT E REJA AKOMODUESE PËR AKOMODIMIN E PËRKOHSHËM TË PERSONAVE QË RIATDHESOHEN SI REZULTAT I GJENDJES SË SHKAKTUAR NGA COVID-19

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", dhe të vendimit nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19", Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 29.4.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e listës me strukturat e reja akomoduese, të cilat i shtohen listës së përditësuar të strukturave akomoduese, të miratuara me vendimin nr.14, datë 23.4.2020, të Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, për akomodimin e përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19.

2. Ngarkohen prefektët e qarqeve Korçë dhe Gjirokastër që të organizojnë procesin e transportit dhe të monitorojnë akomodimin e personave të riatdhesuar në strukturat akomoduese, sipas listës së miratuar me këtë vendim, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të parashikuara në vendimin nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19".

3. Ngarkohen prefektët e qarqeve Shkodër dhe Kukës që të organizojnë procesin e transportit dhe të monitorojnë akomodimin e personave të riatdhesuar në strukturat më të afërta akomoduese, sipas listës së miratuar me vendimin nr.14, datë 23.4.2020, të Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile, për akomodimin e përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19, në bashkëpunim me institucionet e përcaktuara në vendimin nr.311, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të personave që riatdhesohen si rezultat i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19".

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe prefektët e qarqeve Korçë, Gjirokastër, Shkodër dhe Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINISTROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**LISTA E PËRDITËSUAR E STRUKTUARVE AKOMODUESE TË EVIDENTUARA NGA UTSH DHE ATA DHE TË DAKORDËSUAR NGA MTM**

| **Nr.** | **Emri hotelit** | **Vendndodhja Hotelit** |
|---|---|---|
| 1. | Hotel “AS” | Golem |
| 2. | Hotel “Ibiza” | Golem |
| 3. | Hotel “Bonita” | Golem |
| 4. | Hotel “Sun” | Durrës |
| 5. | Hotel “Gloria” | Golem |
| 6. | Hotel “Horizont” | Durrës |
| 7. | Hotel “Brilliant” | Golem |
| 8. | Hotel “Kolaveri” | Mali i Robit |
| 9. | Hotel “Fafa” | Golem |
| 10. | Hotel “Eter” | Mali i Robit |
| 11. | Hotel “Dolce Vita” | Golem |
| 12 | Hotel “Brothers Dijon” | Golem |
| 13 | Hotel “Alvin” | Golem |
| 14 | Hotel “Belmondo” | Golem |
| 15 | Hotel “Bleart” | Golem |
| 16 | Hotel “Casa” | Golem |
| 17 | Hotel “Rafaelo” | Lezhe |
| 18 | Hotel “Kristali” | Korcë |
| 19 | Hotel “Pacili” | Korcë |
| 20 | Hotel “Alysa” | Korcë |
| 21 | Hotel “Medi Nako” | Korcë |
| 22 | Hotel “Eurokorca” | Pogradec |
| 23 | Hotel “Kalaja” | Pogradec |
| 24 | Hotel “Cajupi” | Gjirokastër |
| 25 | Hotel “Number One” | Gjirokastër |

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë